



# 2024 RAPORTI VJETOR

---



# TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                 |    |
|-------------------------------------------------|----|
| Tabela e Përmbajtjes                            | 2  |
| Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv                  | 3  |
| Stafi i Teach for Kosova                        | 4  |
| Reflektim mbi vitin 2024                        | 5  |
| Kohorta e Pestë                                 | 6  |
| Harta e Mbulueshmerisë                          | 8  |
| Instituti Veror 2024                            | 9  |
| Shkolla Verore 2024                             | 10 |
| Playdagogy dhe Rëndësia e Sportit dhe Shëndetit | 11 |
| Sesionet mujore të trajnimit                    | 12 |
| Projektet                                       | 13 |
| Lëvizja Alumni                                  | 19 |
| Partnerët strategjikë                           | 23 |

# MESAZHI NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Të dashur miq dhe mbështetës të Teach For Kosova,

Teksa reflektoj mbi rrugëtimin tonë, ndjem thellësisht krenar për gjithçka që kemi arritur deri më sot. **Viti 2024 shënoi një tjetër kapitull të jashtëzakonshëm për Teach For Kosova, duke konsoliduar përpjekjet tona për të transformuar arsimin në vend.** Këtë vit, mirëpritëm me sukses kohortën e pestë të Fellow-ve, një tregues i qartë se programi ynë vazhdon të frymëzojë të rinjtë dhe të fuqizojë liderët e së nesërme në fushën e arsimit. **Po ashtu, për herë të parë, numri i alumneve tanë ka tejkaluar numrin e Fellow-ve aktualë,** një dëshmi e fortë e trashëgimisë afatgjatë dhe ndikimit në rritje të organizatës sonë.

Një nga arritjet më domethënëse të këtij viti **ka qenë zgjerimi i vazhdueshëm i punës sonë në komuna të reja, duke rritur ndjeshëm shtrirjen dhe ndikimin e Teach For Kosova.** Sot, kemi edukatorë—si përmes Fellow-ve ashtu edhe përmes alumneve—në pothuajse çdo komunë të Kosovës. Krahas kësaj, bashkëpunimi ynë me organizata të tjera të shoqërisë civile në fushën e arsimit është forcuar ndjeshëm, duke kulmuar me një peticion për ndryshime thelbësore në politikat arsimore të vendit. **Jemi veçanërisht krenarë që Teach For Kosova ka qenë në ballë të këtij angazhimi kolektiv, duke treguar përkushtimin tonë ndaj avokimit dhe reformave sistemike.**

Duke parë përpara, jemi të entuziazmuar për mundësitë e reja që na presin. **Këtë vit festojmë pesëvjetorin e Teach For Kosova dhe mezi presim të mirëpresim grupin e gjashtë të Fellow-ve, i cili pritet të jetë më i larmishmi deri më tani.** Po ashtu, kemi synime ambicioze për të forcuar dhe zgjeruar më tej programet tona të alumneve, duke rritur ndikimin afatgjatë të punës sonë. Me lidërshtimin e tyre—si brenda ashtu edhe jashtë klasave—alumnit tanë po formësojnë të ardhmen e arsimit në Kosovë, dhe ne mbetemi të përkushtuar **për t'i mbështetur në çdo hap të rrugëtimin të tyre.**

Asnjë prej këtyre arritjeve nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen tuaj të vazhdueshme. **Ju falënderojmë për besimin dhe përkushtimin tuaj ndaj vizionit tonë për një sistem arsimor më të drejtë dhe gjithëpërfshirës në Kosovë.** Së bashku, po ndërtojmë një themel të fortë për gjeneratat e ardhshme të liderëve.

Me mirënjohje dhe entuziazëm,

Egzon Gashi



# STAFI I TEACH FOR KOSOVA



Drejtor Ekzekutiv

**Egzon Gashi**



Menaxhere per Zhvillim

**Deniza Mulaj**



Menaxher i Financave

**Visar Kurti**



Menaxher i Programit

**Besnik Avdiaj**



Menaxher i Zyrës

**Kastriot Muçolli**



Menaxhere e Projekteve

**Valmira Morina**



Menaxhere e Rekrutimit

**Erlinda Musliji**



Menaxher i Projekteve

**Dardan Konjufca**

**BASHKOHU NË BISEDË**

@teachforkosova



# REFLEKTIM PËR VITIN E KALUAR

“Në vitin 2024, Teach For Kosova vazhdoi programin e saj të **Fellowship-it me 15 Fellows të rinj** dhe gjatë Institutit Veror organizoi edhe sesione të dedikuara për **Edukimin Klimatik dhe Barazinë Gjinore**. Këto sesione synuan të ndërgjegjësojnë pjesëmarrësit mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, qëndrueshmërisë dhe ndërtimit të një shoqërie më të barabartë.”




## Ngjarjet kryesore nga 2024:

- Rekrutuam Kohortën tonë të Pestë të Fellowsëve **12.2 % nga komuniteti Rom**.
- Në bashkëpunim me MPJD-në dhe Konsullaten e Kosovës në Cyrih, organizuam sesion informues për **angazhimin e të rinjve nga diaspora** në Fellowship-in e Teach For Kosova;
- Përfunduam me sukses projektin “Future of Education” që u mbështet nga Teach For All.
- Diplomoi Kohorta e Tretë e Teach For Kosova. **16 Fellows** që diplomuan, u bënë pjesë e **Lëvizjes Alumni** të TFK-së.
- Mbajtëm **Shkollën Verore 2024** në partneritet me Komunën e Prishtinës dhe Komunën e Fushë-Kosovës.
- Zhvilluam projekte në bashkëpunim me Danish Refugee Council (DRC) dhe Teach For All për lehtësimin e mësimi pas shkollës dhe mësimi plotësues për nxënës.


# KOHORTA E PESTË

Në vitin 2024, Teach For Kosova rekrutoi, trajnoi dhe integroi Kohortën e Katërt me 16 liderë të rinj të jashtëzakonshëm. Ne vazhdojmë të rekrutojmë dhe të zgjerojmë ekipin tonë të udhëheqjes kolektive, e cila është e angazhuar në krijimin e ndryshimeve sistematike.


## Etnia



## Fusha e Studimit



## Statistikat e Rekrutimit



- 137 Aplikime të pranuar
- 48 të ftuar në Qendrën e Vlerësimit
- 16 Fellows të pranuar

11.7% e aplikantëve janë **pranuar**.

# KOHORTA E PESTË



Arbesa VISHI

**Komuna:** Kaçanik, Kosovë  
**Bachelor:** Fakulteti i  
Edukimit, Programin Fillor.



Lirika HUMOLLI

**Komuna:** Podujevë, Kosovë  
**Bachelor:** Fakulteti i  
Shkencave Matematiko-  
Natyrore - Departamenti i  
Kimisë.

“Që nga fillimi i karrierës time si mësimmhënëse, kam pasur një dëshirë të vazhdueshme për t'u zhvilluar dhe për të sfiduar vetveten. Kam kërkuar mundësi për t'u pasuruar, për të ndihmuar nxënësit në mënyra më efektive dhe për të rritur aftësitë e mia profesionale. Kur iu bashkova programit të Fellowship-it të Teach for Kosova, ndjeva se kjo mund të ishte mundësia që më duhej për të vazhduar këtë rrugëtim.

*Pjesëmarrja në Institutin Veror të TFK-së ishte një hap vendimtar. Ajo që fillimisht ishte një mundësi për trajnime, shpejt u shndërrua në një përvojë transformuese. Trajnimet intensive dhe shkëmbimi i përvojave me koleget më ndihmuan të rishikoj qasjen time ndaj mësimmhënies. Mësova për fuqizimin e nxënësve, zhvillimin e mendësisë rritëse dhe rëndësinë e planifikimit të qëllimshëm dhe të strategjive efektive për të nxitur të menduarit kritik.*

Tani krahas punës sime si mësuese, jam e angazhuar edhe në projektin për Edukimin klimatik, që është pjesë e programit të Teach for Kosova.

Ky angazhim më ka dhënë mundësinë të nxis nxënësit të kuptojnë lidhjen e ngushtë që kanë me botën që i rrethon. Ata tani po mësojnë dhe praktikojnë kujdesin për mjedisin, duke përfshirë aktivitete si mbjellja e pemëve dhe krijimi i muraleve, për të simbolizuar angazhimin e tyre për një të ardhme më të qëndrueshme.


“Pjesëmarrja ime në Institutin Veror të Teach For Kosova më solli një eksperiencë transformuese në aspektin profesional të mësimmhënies, duke përfshirë edhe atë personal. Jam ndier e sfiduar, e motivuar dhe e frymëzuar njëkohësisht. Trajnimet dhe seminarët cilësorë mbi metodat e mësimmhënies, lidërshtipin, si dhe implementimin e kurrikulës më nxorën nga zona e rehatisë, duke më përmbushur edhe më shumë në rolin tim si ligjëruese.

*Nga ana tjetër, #ShkollaVerore2024 ishte shumë diverse, duke më ofruar mundësinë të reflektoj më shumë mbi rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe qasjes emocionale me nxënësit. Si mësimmhënëse e kimisë, kjo përvojë më ndihmoi të eksperimentoj me metoda më interaktive të të nxënës, duke përfshirë demonstrime praktike dhe punë në grup për të bërë konceptet shkencore më të prekshme dhe të kuptueshme për të gjithë nxënësit.*

Diskutimet dhe aktivitetet që lidhnin teorinë me situata të jetës së përditshme ndihmuan nxënësit të shohin rëndësinë e kimisë përtej librave shkollorë, duke i motivuar ata të jenë më kuriozë dhe të angazhuar në procesin e të nxënës.

Për të theksuar përfitimet e kësaj eksperience, rol kyç patën edhe udhëzimet dhe këshillat e dhëna nga mentorët për të formësuar edhe më tej profesionalizmin tim në mësimmhënie, si dhe përvetësimin e një qasjeje socio-emocionale për një ambient më të rehatshëm dhe efektiv për të gjithë nxënësit.

# HARTA E MBULUESHMËRISË



## Teach For Kosova

Ka krijuar partneritete bashkëpunimi me 16 komuna në mbarë vendin, duke nënvizuar përkushtimin e saj për avancimin e arsimit në Kosovë. Në këtë kuadër, Fellows tanë luajnë një rol të rëndësishëm, duke marrë pjesë aktive në nisma dhe projekte arsimore brenda 32 shkollave publike të shpërndara në të gjithë vendin.

# INSTITUTI VEROR 2024

## NJË VËSHTRIM NGA AFËR

- Trajnuam 15 Fellows për pesë javë me radhë.
- Temat variojnë nga njohja më e thellë e pabarazive në sistemin e arsimit të Kosovës, në luftimin dhe avokimin për ato pabarazi, përmes zhvillimit të Fellows si mësimdhënës liderë.
- Sesione të dedikuara për Edukim Klimatik dhe Barazi Gjinore.
- Sipas sondazhit të zhvilluar pas Institutit Veror, 100% e Fellows do t'ia rekomandonin programin e Fellowship-it një miku ose mikeje, duke e vlerësuar atë me notën maksimale 10/10.



- Edhe këtë vit, për herë të pestë radhazi, Instituti Veror 2024 mirëpriti ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të arsimit dhe leadershipit, folës inspirues dhe liderë të njohur në Kosovë.



# SHKOLLA VERORE 2024.

## NJË VËSHTRIM NGA AFËR

- Shkolla Verore 2024, organizuar nga Teach For Kosova, ofroi një përvojë edukative të pasur për 100 nxënës nga shkolla të ndryshme të Prishtinës, Fushë Kosovës dhe diaspora. Gjatë dy javëve të programit, nxënësit patën mundësinë të përfshihen në aktivitete edukative dhe ndërvepruese që i ndihmuan të zhvillojnë aftësi të ndryshme për jetën.
- Gjatë Shkollës Verore 2024, nxënësit patën mundësinë të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të krijojnë miqësi të reja, duke mësuar të punojnë së bashku për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.



- Përvoja e ndarë me nxënës nga shkolla të ndryshme dhe kultura të ndryshme, ofroi mundësinë që ata të shihnin dhe kuptonin përvoja të tjera, duke e pasuruar kështu të kuptuarit e tyre për diversitetin dhe bashkëpunimin.
- Shkolla Verore ka kontribuar jo vetëm në zhvillimin e aftësive praktike dhe njohurive të reja, por gjithashtu në forcimin e ndjenjës së bashkësisë dhe përkatësisë në një grup që angazhohet për përmirësimin e vetvetes dhe të mjedisit të tij.
- Programi përfshiu një gamë të gjerë lëndësh që trajtuan tematika të rëndësishme, ku disa prej tyre ishin: "Psikologjia e vetërregullimit emocional", "Vullnetarizmi në komunitet", "Aktivizmi për mjedisin", "English for Social Change" dhe "Të mësuarit e kimisë përmes demonstrimeve".



# PLAYDAGOGY DHE RËNDËSIA E EDUKATËS FIZIKE, SPORTIT DHE SHËNDETIT



Në kuadër të sesioneve të Insitutit Veror 2023, **Fellows** e **Kohortës së Pestë**, patën mundësinë të zhvillonin njohuri të thella mbi “Playdagogy dhe rëndësinë e Edukatës Fizike, Sportit dhe Shëndetit” përmes një sesiioni të mrekullueshëm me Gentijana Paçarizi, Alumna e programit.

Fëmijët e Shkollës Verore 2024, u angazhuan në aktivitete të ndryshme duke luajtur dhe mësuar përmes lojërave edukative dhe argëtuese, **ndërkohë që zhvilluan aftësi fizike, mendore dhe sociale.**

Përdorimi i lojërave dhe aktiviteteve fizike ka promovuar shëndetin fizik, mirëqenien emocionale dhe ndërveprimin social, **duke e bërë edukimin një udhëtim të këndshëm dhe të gjithanshëm për çdo fëmijë.**

Ky sesion theksoi **rëndësinë e mbështetjes së zhvillimit të shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve** përmes aktiviteteve fizike dhe edukatës për shëndetin, duke i ndihmuar ata të rriten dhe të zhvillohen në mënyrë të balancuar.



# SESIONET MUJORE TË TRAJNIMIT

## NJË VËSHTRIM MË I AFËRT

Gjatë vitit 2024, ekipi i programit të Teach For Kosova ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme sesione trajnuese mujore, të cilat kanë pasur për qëllim mbështetjen dhe zhvillimin profesional të Fellows, duke i ndihmuar ata të rriten si mësimdhënës liderë në komunitetet e tyre. Këto trajnime janë dizajnuar për të forcuar aftësitë pedagogjike, leadershipin dhe avokimin për një sistem arsimor më gjithëpërfshirës e cilësor.



### Viti i Parë i Fellowshipit: Ndërtimi i Themeleve

Për Fellows e vitit të parë të programit, sesionet mujore janë fokusuar në krijimin e një baze të fortë për mësimdhënien e orientuar në vizion dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me nxënësit dhe komunitetin. Disa nga temat kryesore për këtë vit kanë përfshirë:

- "Mësimi i orientuar në vizion" – Përcaktimi i objektivave afatgjata dhe krijimi i një mjedisi frymëzues për nxënësit.
- "Familjet dhe klasa: Ndërtimi i raporteve efektive për zhvillimin socio-emocional të nxënësve" – Thellimi i bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin për të siguruar një mjedis mbështetës për nxënësit.
- "Vlerësimi i nxënësve dhe hartimi i testeve përmbledhëse sipas taksonomisë së Bloom-it" – Aplikimi i metodave të avancuara të vlerësimit për të matur dhe përmirësuar rezultatet e nxënësve.

### Viti i Dytë i Fellowshipit: Thellimi i Leadershipit dhe Avokimit

Për Fellows në vitin e dytë, trajnimet janë fokusuar në fuqizimin e aftësive të leadershipit dhe avokimit për përmirësimin e sistemit arsimor në komunitetet ku ata veprojnë. Në këtë fazë, Kohorta e 3-të ka marrë pjesë në sesione të avancuara të trajnimit, të cilat kanë përfshirë:

- "Teoria e Ndryshimit dhe Teoria e Leadershipit" – Kuptimi i mënyrës sesi ndryshimet sistemike ndodhin dhe roli i mësimdhënësve si katalizatorë të këtyre ndryshimeve.
- "Mësimdhënia si Leadership Kolektiv" – Ndërtimi i një kulture bashkëpunimi dhe leadershipi kolektiv për të përmirësuar cilësinë e arsimit.
- "Shkrimi i Projekteve" – Trajnim mbi mënyrën se si të hartohen dhe implementohen projekte të suksesshme që ndikojnë në arsim dhe komunitet.
- "Qasja në Drejtoritë Komunale për Arsim" – Mënyrat më efektive për të ndikuar në politikat arsimore lokale dhe për të avokuar për ndryshime pozitive në shkolla dhe komunitet.

# PROJEKTI FUTURE OF EDUCATION

Teach For Kosova ka përfituar nga granti **Future of Education Fund** për të avancuar Projektin e Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve (TPA), një iniciativë që synon të krijojë një sistem të drejtë dhe të zbatueshëm për vlerësimin e mësimdhënësve në Kosovë. Në vitin e parë të projektit, organizata zhvilloi tre instrumente të vlerësimit në bashkëpunim me pesë komuna partnere. **Gjatë kësaj periudhe, u pilotua një sistem i ri i vlerësimit me 500 mësimdhënës në 25 shkolla, duke përfshirë takime të rregullta me drejtorët e shkollave dhe aktorët tjerë relevantë.** Objektivi kryesor i këtij projekti ka qenë krijimi i një procesi vlerësimi që jo vetëm mat performancën, por edhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Për pothuajse dy vite, Teach For Kosova ka punuar intensivisht në zbatimin dhe përmirësimin e këtij sistemi. **Deri më tani, organizata ka bashkëpunuar me 25 shkolla dhe ka përfshirë rreth 392 mësimdhënës në pilotimin e metodave të reja të vlerësimit.** Një aspekt kyç i këtij procesi ka qenë përfshirja e anketave të nxënësve, një ndryshim thelbësor që ka ndikuar drejtpërdrejt në politikën arsimore të vendit. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, Ministria e Arsimit ka miratuar një urdhëresë të re, duke e bërë të detyrueshme përdorimin e anketave të nxënësve në vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.

Ndikimi i këtij projekti ka qenë i dukshëm **jo vetëm në nivel politikash, por edhe në praktikën arsimore të komunave jashtë projektit pilot,** të cilat kanë shprehur interes për të adoptuar sistemin e ri të vlerësimit.

Për t'iu përgjigjur këtij kërkesë, Teach For Kosova ka ndërmarrë hapa konkretë për të ndihmuar komunat në përvetësimin e këtij modeli, përfshirë organizimin e trajnimeve për drejtorët e shkollave dhe zyrtarët arsimorë lokalë. **Falë angazhimit të Fellows dhe Alumni të saj, organizata ka arritur të zgjerojë ndikimin e projektit, duke e bërë atë të aksesueshëm për një gamë më të gjerë të institucioneve arsimore.**



# PROJEKTI FUTURE OF EDUCATION

Nëpërmjet këtij projekti, Teach For Kosova ka nxjerrë një mësim të rëndësishëm: ndryshimet sistematike kërkojnë përfshirje të drejtpërdrejtë të atyre që preken më shumë prej tyre. Në këtë rast, kyç ka qenë bashkëpunimi i ngushtë me mësimdhënësit, të cilët fillimisht kishin shqetësime mbi drejtësinë dhe objektivitetin e vlerësimit.

TFK ka punuar për të adresuar këto shqetësime nëpërmjet **transparencës dhe komunikimit të hapur, duke siguruar që procesi i vlerësimit të jetë i drejtë dhe i dobishëm për të gjithë**. Rezultatet e kësaj qasjeje kanë qenë inkurajuese, pasi mësimdhënësit kanë shprehur besim në modelin e ri të vlerësimit dhe në përfitimet që sjell ai për zhvillimin e tyre profesional.

**Në aspektin financiar, fondet janë përdorur kryesisht për:**

- Zhvillimin dhe pilotimin e instrumenteve të vlerësimit
- Organizimin e takimeve me aktorët kyç
- Mbështetjen e përhapjes së sistemit në një shkallë më të gjerë

Teach For Kosova ka kërkuar një zgjatje të periudhës së zbatimit të projektit, për të përfshirë më shumë palë të interesit dhe për ta përfunduar procesin në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse. **Në fazën përfundimtare, organizata planifikon të analizojë rezultatet e vlerësimeve dhe të organizojë një konferencë kombëtare**, ku do të diskutohen gjetjet kryesore me të gjithë aktorët e përfshirë.

Në përfundim, **mbështetja nga Future of Education Fund ka lejuar Teach For Kosova të krijojë dhe të zbatojë një sistem inovativ të vlerësimit të mësimdhënësve, i cili ka potencialin për të transformuar arsimin në Kosovë**. Bashkëpunimi i gjerë me shkollat, komunat dhe Ministrinë e Arsimit e pozicionon këtë projekt si një reformë kyçe për të ardhmen e edukimit në vend.



# CLIMATE EDUCATION AND LEADERSHIP

Në periudhën prill 2024 - mars 2025, **Teach For Kosova, me mbështetjen e Teach For All, ka implementuar projektin "Climate Education and Leadership"**, i cili synonte promovimin e edukimit mbi ndryshimet klimatike në Kosovë, fuqizimin e mësuesve dhe nxënësve për të ndërmarre veprime konkrete në mbrojtje të mjedisit, si dhe krijimin e një komuniteti të ndërgjegjësuar mbi sfidat klimatike.

Në fazën fillestare, në kuadër të Institutit Veror 2024, u organizua një trajnim intensiv me Fellows të kohortës së pestë të Teach For Kosova. **Ky trajnim, u përqendrua në temat kryesore të edukimit mbi klimën, integrimin e tyre në kurrikulën ekzistuese dhe fuqizimin e vajzave si lidere klimatike.** Të gjitha sesionet u udhëhoqën nga një eksperte e jashtme e edukimit mbi klimën.

Nga shtatori 2024 deri në shkurt 2025, pesë shkolla, kryesisht nga zona rurale, u përfshinë në projekt. **Fellows të Teach For Kosova, të cilët punojnë si mësime dhënë në këto shkolla, integruan edukimin mbi klimën në planprogramet mësimore dhe organizuan aktivitete mujore për nxënës.** Këto aktivitete përfshinë mbjelljen e luleve, pastrimin e ambientit, debatet mbi ndryshimet klimatike dhe ekspozitat me vepra artistike që trajtonin temën e mjedisit. Përmes kësaj qasjeje praktike, nxënësit patën mundësinë të mësojnë në mënyrë aktive dhe të angazhohen drejtpërdrejt në ruajtjen e mjedisit të tyre.

Në përfundim të projektit, secili grup nxënësish realizoi një aktivitet simbolik që shërben si mesazh i qëndrueshëm nga projekti. **Disa grupe zgjedhën të mbjellin pemë në oborrin e shkollës, një tjetër grup krijoi një mural vetëdijësues mbi ndryshimet klimatike, ndërsa një grup tjetër realizoi një kënd ekologjik brenda shkollës.** Këto aktivitete u organizuan me pjesëmarrjen e prindërve, stafit shkollor dhe komunitetit, duke siguruar një ndikim më të gjerë dhe një ndërgjegjësim të shtuar mbi rëndësinë e edukimit klimatik.

Projekti "Climate Education and Leadership" **ka pasur një ndikim të dukshëm në rritjen e kapaciteteve të mësime dhënëve, ndërgjegjësimin e nxënësve dhe angazhimin e komunitetit në temat klimatike.**



# REKRUTIMI NË DIASPORË

Në kuadër të projektit “Shkolla Verore 2024” financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Teach For Kosova realizoi një vizitë në Cyrih, ku u pritën në Konsullata e Republikës së Kosovës. **Kjo vizitë kishte dy qëllime kryesore: angazhimin e të rinjve nga diaspora për t’u bërë pjesë e programit të Fellowship-it të Teach For Kosova dhe krijimin e mundësive për bashkëpunim me mësimdhënësit e shkollave shqipe, duke kuptuar sfidat me të cilat ata përballen.**

Gjatë takimit me studentët dhe të sapodiplomuarit shqiptarë, diskutuam për programin e Fellowship-it të Teach For Kosova si një mundësi për zhvillim profesional dhe për të kontribuar në arsim. **Pjesëmarrja e studentëve krijoi hapësirë për një diskutim të frytshëm për ndikimin që ata mund të kenë në Kosovë dhe rëndësinë e kthimit të përvojës së tyre për të përmirësuar sistemin e arsimit.**

Në anën tjetër, takimi me mësimdhënësit e shkollave shqipe solli një perspektivë të re për sfidat e ruajtjes së gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë. **Në një bisedë të hapur me mësimdhënësit, u diskutua për nevojën për mbështetje më të madhe institucionale dhe mënyrat se si mund të krijojmë ura bashkëpunimi mes tyre dhe Teach For Kosova.** Ata shprehën gatishmërinë për të kontribuar në aktivitetet tona, si shkolla verore, duke ofruar mbështetje në promovimin e programit dhe ndarjen e kësaj mundësie me nxënësit e diasporës.

Konsullata e Kosovës në Cyrih e mirëpriti këtë iniciativë dhe shprehu gatishmërinë për të mbështetur angazhimin e diasporës në fushën e arsimit. **Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm drejt forcimit të lidhjeve me komunitetin shqiptar në Zvicër dhe hapjes së mundësive për bashkëpunime të reja në të ardhmen.**

Duke u bazuar në këtë përvojë, **Teach For Kosova synon të zgjerojë aktivitetet e saj me diasporën dhe të krijojë mekanizma të qëndrueshëm për përfshirjen e profesionistëve shqiptarë që janë jashtë vendit në mbështetje të arsimit në Kosovë.**



# FUQIZIMI I MËSIMDHËNËSVE TË RINJ NGA KOMUNITETET ROM, ASHKALI DHE EGJPTIAN

Për të dytin vit radhazi, Teach For Kosova organizoi punëtori të dedikuara për ndarjen e përvojave më të mira të mësimeve në fushën e gjithëpërfshirjes në edukim.

Fellows nga Kohorta e Pestë e Teach For Kosova, së bashku me mësimeve nga tetë shkolla publike, punuan për të zhvilluar aktivitete që do të përfshihen në katalogun e arsimit gjithëpërfshirës. Ky katalog do të ofrojë një përmbledhje të metodave dhe teknikave moderne për mësimdhënie dhe punën me fëmijë, duke avancuar më tej edukimin inkluziv në Kosovë.

Secili grup mësimeve, nga 10 prej çdo shkolle, krijoi 10 aktivitete të veçanta. Në total, pas vitit të tretë, mbi 200 aktivitete gjithëpërfshirëse do të jenë pjesë e këtij katalogu, i cili do të publikohet dhe shpërndahet në të gjitha shkollat e Kosovës gjatë vitit 2025.

Një falënderim i veçantë shkon për mësimeve, të cilët treguan bashkëpunim të jashtëzakonshëm dhe frytdhënës në këto punëtori.

Punëtoritë u mbajtën në tetë komunat partnere: Gjilan, Viti, Hani i Elezit, Istog, Dragash, Fushë-Kosovë, Skenderaj dhe Lipjan.

Gjithashtu, përmes këtij projekti, 50 nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, kanë qenë pjesëmarrës në #ShkollaVerore2024. Këta nxënës u angazhuan në një gamë të gjerë aktiviteteve të dizajnuara për të nxitur edukimin, socializimin dhe arëtimin.

Ky projekt realizohet nga Teach For Kosova me mbështetjen e Këshillit Danez për Refugjatë – DRC dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim në Zhvillim Ndërkombëtar – Sida,



# LET GIRLS THRIVE

Në maj 2024, Teach For Kosova dhe QIKA, me mbështetjen e Teach For All, realizuan fushatën “Peceta nuk është luks” në pesë shkolla publike të Kosovës, duke shpërndarë 12,000 peceta higjienike për nxënëset.

Kjo iniciativë synon vetëdijësimin rreth shëndetit menstrual, rëndësinë e qasjes së vajzave dhe grave në peceta higjienike falas dhe eliminimin e stigmatizimit të menstruacioneve në komunitetin shkollor.

Në kuadër të kësaj kampanje, nxënësit e përfshirë përgatitën dhurata simbolike me produkte menstruale dhe shpërndanë broshura informuese mbi shëndetin menstrual, duke ndihmuar në promovimin e një mjedisi më të hapur dhe të ndërgjegjësuar për këtë çështje.

Në secilën nga pesë shkollat pjesëmarrëse u vendosën kuti me peceta higjienike, ndërsa çdo shkollë u furnizua me 2,400 peceta higjienike, për të siguruar akses të qëndrueshëm për nxënëset.

Një element thelbësor i kampanjës ishte përfshirja e gjithë komunitetit shkollor në edukimin mbi këtë çështje. Në të gjitha shkollat e përfshira, pesë minuta të orës së parë mësimore u ndanë për një bashkëbisedim me nxënësit rreth rëndësisë së higjienës menstruale, duke promovuar ndërgjegjësimin dhe normalizimin e kësaj teme në ambientin shkollor.

Kjo kampanjë u organizua për të shënuar “Ditën Ndërkombëtare të Higjienës Menstruale” dhe u realizua në kuadër të projektit “Let Girls Thrive”, i cili implementohet nga Teach For Kosova dhe QIKA, me financim nga Teach For All.

Fushata u zhvillua në bashkëpunim me komunitetin e Vushtrrisë, Prizrenit, Suharekës, Lipjanit dhe Ferizajt, duke përfshirë aktorë lokalë në përpjekjen për të siguruar qasje të barabartë dhe dinjitoze në produktet higjienike për të gjitha vajzat dhe gratë në Kosovë.



# TEACH FOR KOSOVA ALUMNI

Identifikojnë në mënyrë aktive sfidat arsimore, forcojnë ndërgjegjësimin në vetvete dhe te të tjerët dhe në bashkëpunim të miratojnë zgjidhje. Këta të diplomuar **nuk janë vetëm edukatorë; ata janë aktivistë** të cilët pa u lodhur avokojnë për një sistem arsimor të barabartë dhe gjithëpërfshirës në Kosovë.



## Alumni janë të fokusuar në 3 fusha:

- Udhëheqja e shkollës;
- Politika publike (niveli komunal dhe ministror);
- Ndërmarrjet Sociale.

## Lëvizja Alumni

Në vitin 2024, Lëvizjes Alumni të Teach For Kosova i janë bashkuar **16 Fellows të Kohortës së Tretë**, të cilët në qershor përfunduan me sukses Fellowship-in dyvjeçar të Teach For Kosova.

Aktualisht, **Teach For Kosova ka 45 Alumni** aktivë si pjesë e Lëvizjes.

## Rrjeti Global

Teach For Kosova, bashkë me 62 shtete të tjera në të gjithë botën, **është pjesë e rrjetit global të Teach For All**, të cilët po ndryshojnë thellësisht fushën e arsimit.

**Albina Avdyli, Endrit Temaj dhe Arta Hiseni, Alumni të Teach For Kosova**, kanë pasur mundësinë të jenë pjesë e Fellowship-it 1-vjeçar për **Leadership në Edukim nga Teach For All**, duke u bërë pjesë e gjeneratës së dytë të **European Alumni Leadership Fellowship**.



# PARTNERËT STRATEGJIKË



## Teach For All

Përmes fondeve të Teach For All, Teach For Kosova synon të mbështesë dhe të fuqizojë disa nga gjeneratat e ardhshme të grave udhëheqëse në Kosovë, në projektin “Let Girls Thrive”. Po ashtu, në kuadër të projektit Climate Education and Leadership, TFK po punon për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështjet klimatike dhe për të integruar edukimin mjedisor në shkolla.

# 01



Në vitin 2024, Teach For Kosova ka filluar të zbatojë projektin 3 vjeçar “Fuqizimi i mësimdhënësve të rinj nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian” i cili është mbështetur nga Këshilli Danez për Refugjatë përmes fondeve të Agjencionit Suedez për Bashkëpunim në Zhvillim Ndërkombëtar – Sida.

# 02



# PARTNERËT STRATEGJIKË



Teach For Kosova ka vazhduar bashkëpunimin me NED duke filluar implementimin e projektit "Promovimi i Mendimit Kritik dhe Aktivizmit Qytetar të Rinjtë" në 6 komuna të Kosovës. Ky projekt synon zhvillimin e mendimit kritik dhe aktivizimin e qytetarisë aktive.

## 03



Republika e Kosovës  
**MINISTRIA E PUNËVE  
TË JASHTME DHE DIASPORËS**

Me mbështetjen e MPJD-së, Teach For Kosova realizoi me sukses "Shkollën Verore 2024" me pjesëmarrjen e fëmijëve nga diaspora dhe organizoi një sesion informues në Cyrih, Zvicër për të studentët dhe mësimdhënësit shqiptarë, duke promovuar programin e Fellowship-it dhe mundësitë e bashkëpunimit.

## 04



# PARTNERË STRATEGJIKË DHE SPONZORË



Edhe gjatë vitit 2024 kemi vazhduar partneritetin me Komunën e Prishtinës dhe Fushë-Kosovës, për organizimin e Shkollës Verore, ku 100 nxënës nga shkollat e këtyre komunave morën pjesë në këtë edicion.

## 05



**Coca-Cola**  
**HBC**

Me përkrahjen e Coca Cola Hellenic, Teach For Kosova ka realizuar me sukses Institutin Veror 2024, duke krijuar një ambient më të këndshëm dhe energjik për pjesëmarrësit. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në krijimin e një eksperience më të rehatshme për të gjithë të përfshirët në këtë program të rëndësishëm arsimor.



## 06

# PARTNERËT STRATEGJIKË



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT



## PARTNERITETET ME SEKTORIN PUBLIK

Komuna e Prishtinës  
Komuna e Fushë Kosovës  
Komuna e Ferizajt  
Komuna e Prizrenit  
Komuna e Gjakovës  
Komuna e Skenderajt  
Komuna e Suharekës  
Komuna e Rahovecit

Komuna e Podujevës  
Komuna e Lipjanit  
Komuna e Decanit  
Komuna e Shtimes  
Komuna e Malishevës  
Komuna e Drenasit  
Komuna e Pejës  
Komuna e Mitrovicës

## PARTNERITETET ME ORGANIZATA

OJQ QIKA  
Germin  
Roma Versitas Kosovo

Voice of Roma, Ashkali & Egyptians  
OJQ Durmish Aslano  
The Ideas Partnership

## PARTNERITETET ME UNIVERSITETE

Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"  
Universiteti i Shkencave të Aplikuara  
në Ferizaj  
Universiteti i Prizrenit  
"Ukshin Hoti"

Universiteti i Pejës  
"Haxhi Zeka"  
Universiteti i Gjakovës  
"Fehmi Agani"  
Universiteti i Mitrovicës  
"Isa Boletini"



## LËVIZJE PËR ARSIM CILËSOR

“

Në një të ardhme, të gjithë fëmijët e Kosovës – pa marrë parasysh prejardhjen apo etninë – do të kenë qasje në një sistem arsimor që i përgatitë ata për një sukses të përjetshëm.

”

+383 49 170 597  
[www.teachforkosova.org](http://www.teachforkosova.org)

Prishtinë  
Rr. Rexhep Luci 30/8  
10000 Prishtinë, Kosova,